



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës

Opština Priština –Municipality of Prishtina

KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe
"STUDIO HAPSIRA" SH.P.K., MATI 1, PRISHTINË, 601053797, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"),
ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

”Rividimi i Projektit kryesor ,unaza qendër Prishtinë“

Nr. i prokurimit ¹	616-22-3896-2-2-1/C831
Nr i brendshëm	616 22 058 221

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim: Revidimi i projektit kryesor unaza qender Prishtine, pjesa perendimore Rrethrrrotullimi Lakrishte - rrethrrutullimi Arberi (krahu majtas) km 0+337.00-1+300.00L=963.00m per segmentin nga profili P4 deri te profili P29 ... Sipas Paramases dhe Paralogarise " me numër identifikues: 616-22-3896-2-2-1

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 33 332,47 €; [tridhjet e tre mijë e treqindje e tridhjet e dy euro e katerdhjet e shtat euro cent] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) Ishëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

Neni 4**Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Drejtor I prokurimit			
Emri:	Nexhmi Mekollı	Emri:	EDMOND HALIMI
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29-06-2022	Data:	29-06-2022
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tendoeruesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-22-3896-2-2-1/C831

Neni 1 Përkusizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për offrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përsitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përm bushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshire në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo konratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërpërjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetat, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush dyerimt e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi përfunduar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i dyeruar të paguajë interes përfunduar e vonuara, përmosrealizim ose përfundërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit përfunduar kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palen tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrin, Ofrofuesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative përfunduar plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetet e tillë alternative përvëç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofrofuesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofrofuesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhëne nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim përfunduar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofrofuesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofrofuesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofrofuesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofrofuesi i Shërbimeve është dënuar përfunduar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofrofuesi i Shërbimeve është shpallur fajtor përfunduar për sjellje të rëndë të keq jo profesionale të dëshmuan me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofrofuesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* përfunduar, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofrofuesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin e kontratës;
- (j) Ofrofuesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofrofuesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofrofuesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëshëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpresë kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafitë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të janë bashkërisht dhe vazhdimesh të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelvisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund t'ë zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do t'ë ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do t'ë përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëneve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do t'ë, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do t'ë ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe t'ë duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do t'ë vazhdoj t'ë jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do t'ë jetë në formën e dhënës në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do t'ë merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do t'ë marr dhe do t'ë ruaj, dhe do t'ë shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do t'ë specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkësë të Autoritetit Kontraktues, do t'ë ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Përmet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do t'ë bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do t'ë bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkësës për pagesë, duhet t'ë përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet t'ë paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do t'ë jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do t'ë jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkësat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund t'ë pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund t'ë plotësohet sepse shuma nuk do t'ë paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund t'ë mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund t'ë bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim t'ë kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do t'ë japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha e pagesës do t'ë llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofrcuesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Ofrcuesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofrcuesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofrcuesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofrcuesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofrcuesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofrcuesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofrcuesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofrcuesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuenca e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofrcuesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofroesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofroesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofroesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofroesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofroesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VECANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksi i do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e fillimit te Sherbimeve do te caktohet ne planin per menaxhim te kontratës , i cili nuk mund te jete me vone se 15 dite nga nënshkrimi i kontrates
	6.4	Data e Përfundimit është 45 dite .
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>Prishtine</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet nga ZKA-ja
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontraten është 10% të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% me vlefshmëri prej 90 dite.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	n/a
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në për projekte e dorëzuara do të autorizohen nga Menaxheri i kontratës i caktuar nga Komuna (Punëdhënësi). Pagesa e fundit –nuk mund të jetë më e vogël se 10% e çmimit të kontraktuar, bazuar ne konstatimin e menaxherit dhe mbikqyresit e kontratës.
Kontrolli i kualitetit	17.1	n/a
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

REVIDIMI I PROJEKTIT KRYESOR ME TITULL : „PROJEKTI KRYESOR, UNAZA QENDËR PRISHTINË, Pjesa PERENDIMORE LOT2: RRETHROTULLIMI LAKERISHTE-RRETHROTULLIMI ARBERI(KRAHU MAJTAS) KM 0+337.00-1+300.00. L=963.00M PËR SEGMENTIN NGA PROFILI P4 DERI TE PROFILI P29(I SITUACIONIT), LOT 2 KM0+337.00-0+620.00(KRAHU MAJTAS), -(PROJEKTI I URAVE-LIBRI 3 DHE RRUGËS LIBRI 1)

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Nr.	Emërtimi i pozicionit	Njësi	Sasia	Çmimi njësi	Shuma me TVSH(€)
1	Incizimi gjeodezik dhe përpilimi i Elaboratit Gjeodezik, për Revidimin e projektit (ky pozicion është paraparë për meter gjatësi të rrugës dhe urës L=500m gjëresi 2x17.5 m ,nga aksi i rrugës së bashku me urë).	m'	500	1.15	575.00
2	Projekti kryesor i urës me gjatesi L=230 m dhe gjëresi Bmin=9.5mm sipas kërkesave të Detyrës Projektuese,të parashihen kanalet e ujërave sipërfaqësorem, kanalet e kabllave elektrike dhe riqimit publik,etj...	m ²	2612.5	8.00	20900.00
3	Projekti kryesor i rrugës,me gjatësi L=265 m dhe gjëresi B=12m, sipas kërkesave të Detyrës Projektuese	m'	265	0.53	140.45
4	Projekti kryesor i Kanalizimit Fekal sipas kërkesave të Detyrës Projektuese	m'	200	0.51	102.00
5	Projekti kryesor i kanalizimit atmosferik për rrugën sipas kërkesave të Detyrës Projektuese	copë	300	0.52	156.00
6	Projekti kryesor i rrjetit të ujësjellësit për rrugën sipas kërkesave të Detyrës Projektuese	m'	200	0.52	104.00
7	Projekti kryesor i Kanalizimit kabllor energetik dhe optik për rrugën sipas kërkesave të Detyrës Projektuese	m'	200	0.53	106.00
8	Projekti kryesor i ndriçimit publik sipas kërkesave të Detyrës Projektuese	m'	200	0.51	102.00
9	Elaborati gjeomekanik-(duhet të bëhen shpime në thelli si paku 10m,nëse kjo thelli nuk mjafton(për strukturat-urat,muret) deri te shtresa e fortë,shpimi duhet të vazhdojë.Gjithësejtë duhen të mirren nga pesë mostra për çdo themel të vequar të shtyllave dhe pesë mostra për shtyllën bregore të urës,ndërsa në gjatësinë e rrugës të mirren së paku tri mostra.Në fund duhet të përpilohet elaborati gjeomekanik sipas kërkesave të Detyrës Projektuese dhe sipas standardit Eurocod 7).Llogaria bëhet në m' të thelli si së shnimit	m'	216	1.22	263.52
10	Projekti i Sinjalizimit horizontal dhe vertikal sipas kërkesave Detyrës Projektyese,për urën dhe rrugën	m'	450	0.52	234.00
11	Projekti kryesor i Mureve mbrojtëse me lartësi H>1.5m,për të dy anet e rruges	m'	530	1.15	609.50
12	Projekti i Kryesor i udhëkryqit - lidhja e rrugës së planifikuar sipas Planit Rregullues me rrugën e planifikuar paralel me hekurudhën, dhe sipas situacionit të paraqitur në Detyrën Projektuese	copë	1	1000.00	1000.00
13	Projekti i shpronësimit (nenkuptohet elaborati i shpronësimit per te dy anet e rruges dhe urës). Gjatësia L=500m dhe gjëresi B=16 m.	m ²	8000	1.13	9040.00
Gjithësejtë me TVSH:					33332.47

Kontraktuesi mban përgjegjësin rreth hartimit të projektit dhe dëmeve që eventualisht mund të rrjedhin nga mos realizimi i saktë dhe profesional i hartimit të këtij projekti.



Deklaratë e garantuesit

GARANCI KONTRATE POLICA NR. 070010260006338

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: STUDIO HAPSIRA SH.P.K
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: "Rividimi i Projektit kryesor ,unaza qendër Prishtinë "

Numri i Prokurimit: 616-22-3896-2-2-1

Garacion me kërkësë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues.

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitoi sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit

DHE NGASE jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtenëshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej 3,333.25 € Tre mijë e Tre qinde e Tridhjete e Tre e Njezet e Pes / njeqind Euro zotohemti të ju paguajmë, që me kërkësën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbmbushja e njërit nga kushtet në vijim :

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar, dhe si rezultat i sajë kanë mbet pa u paguar shumë punëtor, nënkontraktor dhe / ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 3,333.25 € siç është thënë më lart, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa ma shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkësës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me daten 29.9.2022



Nënshkrimi dhre vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit finanziar

Adresa: Rr. Qamil Hoxha, nr.51, Prishtinë

Data: 30.6.2022



CERTIFIKATË SIGURIMI PËR GARANCINË E KONTRATAVE (UVERENJE OSIGURANJA ZA GARANCIJU UGOVORA)

Nr i Policës / Br.Polise / Policy No. 070010260006338

Nr Serik / Serijski br. / Serial num. 6338

Garantuesi / Davalac garancije / Warrantor:	Kompania e Sigurimeve Siguria		
Adresa / Adresa / Address:	Rr. Luan Haradinaj Prishtine		
Përfaqësia / Predstavnistvo / Branch Office:	PRISHTINË		
Ajgenti / Agent / Agent:	Rexhep Haziri		
Banka e Garantuesit / Banka davalaca garancije / Warrantors Bank:	Banka Ekonomike		
Nr. Xhirollgarise / Br. Zhiraquna / Account No:	1401000000860384		
Kontraktuesi / Ugovoraç / Contractor:	STUDIO HAPSIRA SH.P.K		
NRB / BRN:	810834699 - 810834699		
Adresa / Adresa / Address:	MATI 1		
Përfaqësuar nga / Predstavljen od / Represented by:	EDMOND HALIMI		
Përshkrimi i aktivitetit / Kontratës që është objekt i Kontratës së Garancisë / Description of the activity / Contract - the subject matter of the performance bond / Opis aktivnosti / Ugovora koji je objekat Garancije			
Titulli i Kontratës / Naslov ugovora / Contract Title:	"Rividi i Projektit kryesor ,unaza qendër Prishtinë "		
Numri Referencës / Br preporuke / Licenses Reference Number:	616-22-3896-2-2-1		
Përfitusi / Korisnik / Beneficiary:	KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES		
Adresa / Adresa / Address:	TREPQES NR.2		
Shuma e Garantuar / Garantovani iznos / Guaranteed Sum:	3,333.25 €		
Periudha e Garancisë / Period Garancije / Period of Guarantee:	30.6.2022	Deri më / Do / Until	29.9.2022
Primi / Premija / Premium:	Primi / Premija / Premium	TVSH / PDV / VAT	TOTALI / UKUPNO / TOTAL
Data / Datum / Date: 30.6.2022	59.50 €	10.71 €	70.21 €

Certifikata e garancisë është e vlefshme kur bashkëlindhur me të gjendet kontrata e garancisë e cilës përbën kushjet e sigurimit të garancisë dhe që së hashku me formen propozuese janë pjesë përfisive e certifikatës së garancisë. Garantuesi K.S. SIGURIA merr përsipër që ne rast se kontraktuesi nuk u përgjigjet detyrimeve të tij PËRFITUESIT te shumës se garantuar te plotësojnë detyrimet deri ne shumën e garantuar siq përkalohet në këtë certifikate dhi ne kushjet e kontrates mbi bazën e të cilës lëshohet kjo certifikate Garancie. Garantuesit më përmbyshin e detyrimeve të Kontraktuesit ndaj Përfitusit të garancisë, i lind e drejtë që te veuproje kundrejt Kontraktuesit (cedimi i së drejtës) ne të jetën mënyrë siq do te kushte veprues përfitusi i garancisë ne rastin kur kjo CERTIFIKATE GARANCIE nuk do të ishte lëshuar.

Uverenja garancije je vëzësë kada u prillogu se nalazi i ugovor garancije koji saldzi ushove osiguruese garancije koja zajedno sa predlagofëkum formom su sastavni deo uverenja garancije. Davalac garancije K.O.SIGURIA obavezuje se da u ukoliku ugovorët se ne odaziva obaveza KORISNIK garantiuar iznosa është isputni obaveze do garantovanog iznosa kao që se utvrdije ovim uverenjem i ushvima ugovora na bazë të cilës që i zërtonte ovo uverenje garancije Davacoc garancije ispunjavaret obaveza Ugovorët prema Korisniku garancije, daje se pravo da deluje prema Ugovorët (povreda prava) na tështu ukuqen që i ka qenë i uverenje garancije.

Performance Bond certificate is valid when attached to it is the Warranty Contract which contains general conditions of the Performance Bond, so that together with the proposal form composes structural part of the Performance Bond certificate. Warrantor K.S. SIGURIA guarantees that in case if contractor will not respond to his duties and responsibilities towards the Beneficiary of the guaranteed sum to fulfil those duties up to the guaranteed sum as described in this certificate and in the general conditions of the contract, based upon the General Conditions for the issuance of this certificate of warranty. With the fulfillment of the duties of the Contractor towards the Beneficiary of this warranty, Warrantor has the right to act towards the contractor in the same manner as the beneficiary of the warranty would act in case that this Performance Bond Certificate would not be issued.

SIGURIA
Garantuesi / Davalac garancije
Warrantor / Insurer
KOMPANIJA E SIGURIMI

Departamenti i marjes ne Sigurim / Odjeljenje za prijem
osiguranja / Department of Insurance Receipts



Kontraktuesi / Ugovoraç / Contractor:
STUDIO HAPSIRA SH.P.K.



KOMUNA E PRISHTINËS
Zyrtari Kryesor Administrativ

nr. 1A-020/05-151844h2 datë 30 06. 2022

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

V E N D I M

1.Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit e realizimit te kontratës për kontratën:
“ “ Revidimi i projektit kryesor te unazës qendër Prishtinë”, “

numri i prokurimit 616 22 058 221

1. Besim Qelaj - caktohet menaxherë i kontratës

Mbikëqyrës për realizimin e kontratës sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet:

- Hazir Krasniqi– Mbikëqyrës i menagjerit te Projektit
- Syzana Pllana– Mbikëqyrës
- Bashkim Statovci- Mbikëqyrës

2. Menaxheri i kontratës, obligohet qe të hartoj një Plan të te Menaxhimit te Kontratës, duke përdorur formularin Standard te miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e te dy palëve (Menaxherit te kontratës se AK dhe Menaxherit te Kontratës se OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar te planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
3. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës
Përparim Rama**

Albina Bajrami

From: Aferdita Hasimi
Sent: 28 June, 2022 11:07
To: Albina Bajrami
Cc: Nexhmi Mekolli; Krenar Xhaferi
Subject: Njoftim

Te nderuar

Per aktivitetin e prokurimit, " **Revidimi i projektit kryesor te unazës qendër Prishtinë**", propozoj keta anetare:

Menaxher i kontrates

1. Besim Qelaj

Organ Mbikqyres

1. Hazir Krasniqi
2. Syzana Pilana
3. Bashkim Statovci

Me respekt,
Aferdita Hasimi
u.d. Udhëheqëse e S.I.K
Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të kontratave
Komuna e Prishtinës

e-mail: aferdita.hasimi@rks-gov.net
tel: +381 (0)38 230 900

From: Albina Bajrami <Albina.Bajrami@rks-gov.net>
Sent: Tuesday, June 28, 2022 9:45 AM
To: Aferdita Hasimi <aferdita.hasimi@rks-gov.net>
Cc: Krenar Xhaferi <Krenar.Xhaferi@rks-gov.net>; Nexhmi Mekolli <Nexhmi.Mekolli@rks-gov.net>
Subject: KERKESE

Te nderuar

Kërkojmë nga ju qe te caktoni ekipin mbikëqyrës për aktivitetin e prokurimit" Revidimi i projektit kryesor te unazës qendër Prishtinë "

Ju faleminderit per mirëkuptim!

Me respkt

Albina Bajrami
Zyrtare e Lartë e Prokurimit
Prokurimi Prishtinë
Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës

e-mail: albina.bajrami@rks-gov.net

Kerkoje nga Ju qe te caktoni tre (3) antarë per komision te vlersimit per aktivitetin " Rividimi i projketit kryesor te unazës qendër Prishtinë "

Ju faleminderit per mirëkuptim!

Me respkt

Albina Bajrami
Zyrtare e Lartë e Prokurimit
Prokurimi Prishtinë
Kabineti i Kryetarit
Komuna e Prishtinës

e-mail: albina.bajrami@rks-gov.net
tel: +383 (0)38 230-900-11-33